




Më 25 nëntor

# JO INICIATIVËS SË RREZIKSHME «VETËVENDOSËSE» TË SVP-SË



«Unë i them JO sulmit frontal që i bëhet të drejtave të mbrojtura të njeriut. Nisma kërkon që Zvicra të shkelë detyrimet e saja ndërkombëtare, ashtu si bëjnë vetëm sundimtarët totalitar.

Unë e refuzoj këtë nismë.»

Arbër Bullakaj, Nënkryetar i SP të kantonit St. Gallen dhe asamblist në Wil



«Unë i them JO mosrespektimit të traktateve ndërkombëtare. Vetëm traktatet ndërkombëtare dhe e drejta ndërkombëtare mbrojnë vendet e vogla si Zvicra nga politikat imponuese të fuqive botërore. Po këto traktate, Trump, Putin dhe Erdogan përcaktojnë se çfarë të ndodh në botën tonë.»

Barbara Gysi, deputetet në Dhomën Nacionale të Parlamentit të Zvicrës, St. Gallen



«Unë i them JO cënueshmërisë së njerëzve nga arbitrariteti shtetëror. Të drejtat ndërkombëtare të njeriut na mbrojnë nga kufizimet arbitrare të lirisë sonë nga shteti. Nisma në fjalë rrezikon këto të drejta.»

Osman Osmani, nën/kryetar i Migrantëve të Partisë Socialdemokrate të Zvicrës; sekretar nacional për migracion në Unia; deputet në Parlamentin e Schaffhausen

## JO SULMIT FRONTAL KUNDËR TË DREJTAVE TË MBROJTURA TË NJERIUT:

Kjo nismë paraqet sulm frontal të SVP-së kundrejt të drejtave të mbrojtura të njeriut. Ajo nuk është e vetme në këtë qëllim. Në të gjithë botën, vendet represive dhe sundimtarët e korruptuar, që ndjekin interesat e tyre, minojnë të drejtën ndërkombëtare. Pikërisht tani, përkushtimi i fortë i Zvicrës për të drejtat e njeriut është më i rëndësishëm se kurrë. Nuk mund të lejojmë që Zvicra të shpërfillojë detyrimet e saja ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, siç bëjnë shtetet e padrejta dhe sundimtarët totalitar.

## JO MOSRESPEKTIMIT TË TRAKTATEVE NDËRKOMBËTARE:

Traktatet ndërkombëtare dhe e drejta ndërkombëtare mbrojnë vendet e vogla si Zvicra nga imponimet politike të fuqive botërore. Disa prej tyre po bëhen gjithnjë e më nacionaliste. Pikërisht tani është më se e rëndësishme që Zvicra të mbrojë dhe respektojë rregullat ndërkombëtare. Vetëm një sistem i fortë i drejtësisë mund të kufizojë arbitraritetin e shtetit. Pa rregulla ndërkombëtare, sundimtarët si Trump, Putin dhe Erdogan përcaktojnë se çfarë ndodh me botën. Prandaj, JO për këtë nismë të rrezikshme të SVP-së.

## JO PAMBROJTSHMËRISË NGA ARBITRARITETIT SHTETËROR:

Të drejtat ndërkombëtare të njeriut na mbrojnë nga kufizimet arbitrare të lirisë sonë nga shteti. E drejta ndërkombëtare dhe para së gjithash Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ) përforcojnë të drejtën e banimit, të drejtat e fëmijëve për të jetuar me familjet e tyre dhe për t'u mbrojtur karshi arrestimeve dhe dëbimeve arbitrare. Iniciativa i sfidon të gjitha këto arritje. Kjo është arsyeja pse ne themi JO.

## SI TË VOTOJMË?


ALBANISCH



Hapni zarfin e transmetimit




Shkruani (JO) NON apo NEIN në fletën e votimit




Vendoseni fletën e votimit brënda zarfit anonim të votës dhe mbylleni atë



Firmoseni kartën e legjitimitetit që ndodhet brënda zarfit të transmetimit



Vendoseni zarfin anonim të votës së bashku me kartën e legjitimitetit brënda zarfit të transmetimit, duke e mbyllur përsëri atë



Dërgoni zarfin e transmetimit brënda datës 17.11. me anë të postës ose çoni votën tuaj deri më 24.11. në kutinë postare të Komunës

## EMIGRANTËT, QOFSHIN GRA APO BURRA, KANË NJË INFLUENCË TË KONSIDERUESHME

Zvicra i ka dhënë shtetësinë vitet e fundit më shumë se një milion njerëzve. Rreth 880 000 zviceranë dhe zvicerane të moshës mbi 15 vjeç kanë një kombësi të dytë. Nëse gjithë këta njerëz me sfond migracioni marrin pjesë në votime, ata mund të përbëjnë shumicën. Një JO si kundërpërgjigje e iniciativës së rrezikshme «vetëvendosëse» mund të bëhet e mundur vetëm nëse të gjithë marrin pjesë në votim!

Kontakti: SP MigrantInnen, Postfach 7876, 3001 Bern, Telefon 031 329 69 69  
info@spschweiz.ch, www.spschweiz.ch/migranten  
PS Migrant-e-s, case postale 7876, 3001 Berne, téléphone 031 329 69 69  
info@pssuisse.ch, www.pssuisse.ch/migrants

